



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCEVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/DEPARTMENT OF FINANCES AND

GENERAL SERVICES/DEPARTMAN I FINASIIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI PËR BURIME NJËREZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit bënë:

Shpallje për Avancim në Karrierë

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Titulli i punës: Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa

Kategoria funksionale / 9 Koeficienti:

Numri i referencës: 15/2016

I përgjigjet: Drejtorit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit

Detyrat kryesore:

1. Menaxhon punën e gjithëmbarshme të njësisë dhe ndihmon udhëheqësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
2. Menaxhon me stafin e divizionit dhe në bashkëpunim me udhëheqësin, organizon punë përmes ndarjes së detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore;
3. Ndihmon udhëheqësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë;
4. Përgatit propozimet buxhetore dhe koordinon çështjet buxhetore për të gjitha strukturat e institucionit;
5. Menaxhon rezervat e parasë dhe siguron se kontrolli i brendshëm financiar është bazuar në parime;
6. Përgatit raporte tremujore, gjashtëmujor, nëntëmujore dhe vjetore mbi shpenzimet buxhetore në bazë të LMFP-së;
7. Konsolidon të dhënat në programin e BDMS në bazë të dhënave nga linjat buxhetore të ministrisë;
8. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.

Procedura e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë shërbyesit civil- 8 ditë.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Njohuri dhe përvojë substanciale lidhur me shpenzimet e parasë publike;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathësi në caktimin e objektivave ,planifikim të punës dhe analizë;
- Shkathësi në udhëheqje në organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Diplomë universitare, Fakulteti Ekonomik, minimum 5 vite përvoje pune profesionale;

Institucioni: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shërbyesit civil brenda MKRS-së.

Data e mbylljes së konkurrimit: 20.10.2016

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" nr. 35. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211-449 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>). „